

**D E K R E T**  
**Nr.1582, datë 15.8.1996**

**PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.7928, DATË 27.4.1995, NDRYSHUAR ME LIGJIN NR.8070, DATË 15.2.1996, DHE ME LIGJIN NR.8126, DATË 9.7.1996 “PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR”**

Në mbështetje të nenit 28, pika 19, të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**D E K R E T O J:**

**Neni 1**

Në nenin 50 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“Për rastet kur në marrëveshjet financiare të ratifikuara në Kuvendin Popullor ose të miratuara nga Qeveria në formën e granteve, parashikohet mospërdorimi i burimeve financiare të huaja për të paguar taksa e tatime, duke përfshirë tatimin mbi vlerën e shtuar. Tatimi i paguar t’u rimbursohet financuesve të huaj nga administrata tatimore brenda 45 ditëve, sipas rregullave të përcaktuara nga ministri i Financave.

**Neni 2**

Ky dekret hyn në fuqi më 1 korrik 1996.

**KUNDËRFIRMOHET**  
**KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVEP RESIDENTI I REPUBLIKËS**  
**Aleksandër Meksi**

**Sali Berisha**